

RUAJTJA E PËRSHTATSHMËRISË SIMË TË SIGURIMIT TË PAPUNËSISË

Tre hapa të thjeshtë çdo javë

Përdorni këtë udhëzues referimi të shpejtë për t'ju ndihmuar të mbani mend se çfarë të bëni çdo javë për të vazhduar marrjen e pagesave të përfitimeve tuaja të sigurimit të papunësisë.

1. KËRKONI PUNË

Mbani mend: Për të marrë përfitimet e sigurimit të papunësisë, duhet të plotësoni kërkesat e shtetit për kërkimin e punës, të tilla si plotësimi dhe dërgimi i aplikimeve për punë te punëdhënësit.

BËNI NJË PLAN DHE VENDOSNI NJË QËLLIM

Çdo javë, identifikoni aktivitete efektive të kërkimit të punës që çojnë në gjetjen e një pune të re.

ZBATONI PLANIN TUAJ

- Kryeni të paktën 3 aktivitete të kërkimit të punës
- Jini i aftë dhe i disponueshëm për punë
- Regjistrohuni me unemployment.labor.ny.gov/en-US/login dhe përdorni në mënyrë aktive faqen tonë të internetit për përputhjen e punës

DOKUMENTONI PËRPJEKJET TUAJA

Mbani një regjistrim të aktiviteteve tuaja të kërkimit të punës. Sigurohuni që të dokumentoni "çfarë, kur, ku dhe me kë", si dhe rezultatet e secilit aktivitet.

2. PLOTËSONI VËRTETIMIN JAVOR TË KËRKESËS

Mbani mend: Nëse nuk e dorëzoni kërkesën tuaj për javën e mëparshme deri në afatin e fundit, pagesa juaj e përfitimit mund të vonohet ose të refuzohet për atë javë!

KUR TË PARAQISNI KËRKESËN TUJ JAVORE

Ju duhet të paraqisni një kërkesë para mesnatës të së shtunës për aktivitetet e javës së mëparshme, nga e hëna deri të dielën.

SI TË PARAQISNI KËRKESËN TUJ JAVORE

- Në internet: Për shërbimin më të shpejtë, aplikoni në unemployment.labor.ny.gov/en-US/login
- Telefoni: (888)581-5812

3. RAPORTONI TË GJITHË PUNËN

ÇFARË PUNE TË RAPORTONI

Ju duhet të raportoni të gjitha orët e punës për çdo javë që punoni kur aplikoni për përfitime të sigurimit të papunësisë, duke përfshirë punën me kohë të pjesshme ose të përkohshme.

KUR TË RAPORTONI PUNËN

Raportoni orët tuaja të punës për javën nga e hëna deri të dielën që keni punuar, JO javën që jeni paguar.

SI TË LLOGARITNI FITIMET BRUTO

Numri i orëve të punuara X Norma e pagesës për orë = Fitimet bruto

Nëse e kuptoni se keni bërë një gabim në kërkesën tuaj javore, kontaktoni menjëherë NYS DOL.



Shikoni udhëzuesin e procesit të përfitimit të pretenduesit të sigurimit të papunësisë.